



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

DEKLARATË

Qytetarët e 28 vendeve anëtare të Bashkimit Europian kanë nisur sot votimin e përfaqësuesve të tyre në Parlamentin Europian.

Kuvendi i Shqipërisë, krenar për kontributin e diasporës mbarëkombëtare në vendet anëtare të Bashkimit Europian, përshëndet përfshirjen e një numri të madh kandidatësh me origjinë shqiptare që garojnë nën siglat respektive politike.

Kuvendi i Shqipërisë e vlerëson këtë fakt si një shembull të qartë të integritit të shqiptarëve në familjen europiane dhe u uron suksese të gjithë kandidatëve.

Miratuar në datën 23.5.2019